



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:274935

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05731153

K.DH.SH.II.nr.1581/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Terminali” ShPK me seli në Han të Elezit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sabri Kryeziu, avokat në Lipjan, kundër të paditurës Komuna e Hanit të Elezit, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.199/22 të datës 15.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit “Terminali” ShPK me seli në Han të Elezit, e datës 16.11.2023, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.199/22 të datës 15.10.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.199/22 të datës 15.10.2023, nën pikën I. është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Terminali” ShPK me seli në Han të Elezit, kundër të paditurit

Komuna e Hanit të Elezit-Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, për anulimin e Akteve Administrative 08-nr.2858/88-2019 i datës 10.04.2019 dhe 08 nr.3692/2019 i datës 13.05.2019 me propozim që gjykata ta aprovoj padinë si të pa bazuar, ti anuloj vendimet e Komunës së Hanit të Elezit-Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, si të kundërligjshëm. Ndërsa, secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar për shkak të: shkeljes së dispozitave procedurale dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Aktgjykimi i Dhomës së Shkallës së Parë të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim, ose aktgjykimi i Dhomës së Shkallës së Parë të ndryshohet, padia e paditësit të miratohet në tërësi si e bazuar dhe të anulohen vendimet e të paditurës 08-nr.2858/88-2019 i datës 10.04.2019 dhe 08 nr.3692/2019 i datës 13.05.2019, duke e liruar paditësin nga pagesa e taksës vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit për vitin 2019 dhe borxhin paraprak në shumë prej 99,000.00€.

E paditura ka paraqitur përgjigje në ankesë duke konsideruar se vendimi i Gjykatës Komerciale KA.nr.199/22 është vendim i bazuar mirë në dispozita ligjore dhe me të drejtë padia e paditësit është refuzuar. Andaj ka propozuar që Dhoma e Shkallës së dytë ta refuzoj ankesën e palës paditëse si të pa bazuar.

Kolegji Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, pas vlerësimit të aktgjykimit të ankimuar, pretendimeve ankimore, në pajtim me nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin 08-nr.2858/88-2019 i datës 10.04.2019 i Komunës së Hanit të Elezit, paditësi është ngarkuar me taksën vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit në shumën totale të obligimit prej 99.000.00€ e cila duhet të paguhet në konton e Buxhetit të Kosovës me dy këste kësti i parë me datë 30.06.2019 dhe kësti i dytë me datë 30.09.2019. ndërsa me vendimin 08 nr.3692/2019 i datës 13.05.2019 është refuzuar ankesa e subjektit afarist Terminali ShPK e parashtruar pranë Komunën e Hanit të Elezit përkatësisht

komisionit për procedurën e zgjedhjes së kontesteve dhe ankesave, kundër aktvendimit të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik për caktimin e taksës vjetore komunale.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Komuna Hani Elezit, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 18.07.2019, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimeve 08-nr.2858/88-2019 i datës 10.04.2019 dhe 08 nr.3692/2019 i të paditurës Komuna Hanit të Elezit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar, duke lënë në fuqi vendimin e lartcekur. Me arsyetim se gjykata vlerëson se e paditura Komuna e Hanit të Elezit –Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka nxjerr aktvendim me nr. 08-nr.2858/88-2019, ku subjekti afarist tani paditësi “Terminali” ShPK i ka caktuar ngarkesë vjetore për vitin 2019, në shumën prej 5,000.00€ ndërsa duke përfshirë edhe borxhin paraprak në vlerë prej 94,000.00€ i ka caktuar ngarkesë vjetore në total prej 99,000.00€. pala e paditur këtë vendim e ka mbështetur duke u bazuar në ligj përkatësisht në dispozitat e nenit 58 par. D) dhe neni 24 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës, neni 10 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal si dhe nenin 15-17 të Rregullores për taksa Tarifa dhe Ngarkesa Administrative e miratuar nr.01/6866-2018 me datë 27.09.2018. gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar në përputhje me autorizimet ligjore bazuar në Ligjin nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal rregullon të hyrat vetanake ku përfshihen edhe taksat komunale të aktuara në bazë të autorizimeve ligjore. Nga një gjendje e tillë e çështjes e paditura e ka nxjerr Rregulloren për Pagesën e Taksave, Tarifave dhe Ngarkesave Administrative në harmoni me ligjin, atëherë gjykata vlerëson se akti administrativ i Komunës së Hanit të Elezit-Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik 08 nr.2858/88-2019 i datës 10.04.2019 në emër të taksës vjetore për zhvillimin e aktivitetit afarist. Vendimi i të paditurës është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për aktet vendimtare, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Andaj bazuar në nenet 13 par.1 nën par 1.12 lidhur me par.5 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me

shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së si dhe mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), në drejtim të thënieve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e paditësit se ekzistojnë shkeljet e dispozitave procedurale nga neni 63 të LKA lidhur me nenin 182 par. 2 pika n) të LPK-së ngase aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nu mund të ekzaminohen e sidomos dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me arsyet e aktgjykimit, aktgjykimi nuk ka fare arsye dhe në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, arsyet janë të pa qarta kontradiktore, ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet në përmbajtje të dokumentit. Dhoma e Shkallës së Dytë të njëjtin e ka shikuar sipas detyrës zyrtare sa i përket kësaj baze ankimore, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së. Po ashtu Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë ka konstatuar se e paditura me rastin e marrjes së vendimit është bazuar në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa Administrative e cila është taksë e veçantë e miratuar nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari e që i miratojnë aktet me qëllim që të ndërmarrin masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre, aktet e tilla janë në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor në Republikën e Kosovës, andaj paditësi në këtë rast është dashur të i përmbahet rregullores së nxjerrë nga Kuvendi Komunal dhe të kryej pagesën e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë së tij afariste në territorin në të cilin vepron dhe punon.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata nuk e ka pasur të qartë se paditësi nuk e ushtron veprimtarinë në lokalet e Komunës, ku detyrimishr do të linte detyrimi për pagesën e taksës vjetore për ushtrimin e veprimtarisë, por paditësi e ushtron veprimtarinë në pronën e tij e që nuk ka kurrfarë detyrimi për taksë komunale sic ngarkohet dhe sic është vendosur nga gjykata e shkallës së parë. Këto pretendime ankimore ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerëson se janë të

pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara. Kjo për faktin se pas shqyrtimit dhe analizimit të dispozitës ligjore dhe rregulloreve komunale, kolegji vlerëson së vendimi është konform ligjeve dhe rregulloreve të miratuara nga Komuna e Hanit të Elezit me anë të cilave përcaktohen taksat vjetore për kategoritë e ndryshme të veprimtarive afariste të cilat e ushtrojnë veprimtarinë afariste në territorin e Komunës dhe duhet të paguajnë taksën komunale për shërbime publike. Andaj, Dhoma e Shkallës së Parë duke analizuar bazën ligjore përkatësisht nenin 8 dhe 10 të Ligjit 03/L-040 për vetëqeverisje lokale si dhe Ligjin 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, me të drejtë ka konstatuar se vendimi i të paditurës është i qartë dhe përmban elementet e detyrueshme të aktit të shkruar të paraparë me nenin 47 dhe 48 të LPPA-së, sikurse akti administrativ i të paditurës 08.Nr.3727/109-2018 të datës 08.05.2018 me të cilin është konstatuar gjendja faktike lidhur me caktimit të taksave ndaj paditësit, ashtu edhe vendimi i kontestuar me padi përmbajnë pjesën hyrëse dhe pjesën urdhëruese në vështrim të nenit 47 par.1 pika 1.1, 1.2 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2019:274935
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05731153

K.DH.SH.II.nr.1581/23, me datë 24.05.2024

**Kryetar i kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**